



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/01-64440 dt. 16.12.2021

Bazuar në nenin 52, të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, UA (MPL) Nr.05/2020 për themelimin e komiteteve të përhershme Neni 3, 4 dhe 7. Si dhe UA Nr. 27/2012 MPB-03/2012, Për këshillat komunale për siguri në bashkësi Neni 3. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z. Milaim Hajdari, me dt. 23.12.2021 (Enjte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET
Mbledhjen e Kuvendit Komunal

Mbledhja do të këtë:


Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes inauguruese i Kuvendit Komunal i mbajtur me: 03.12.2021 dhe procesverbali i mbledhjes së zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit Komunal i dt. 16.12.2021.
2. Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-ca)
3. Themelimi i Komitetit për Komunitete. (KK)
4. Themelimi i Këshillit për siguri në Bashkësi (KKSB)
5. Informim i Kuvendit Komunal për gjashtëmuorin e dytë të KKSB-së.
6. Të ndryshme.

Drenas, 16.09.2021



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060/04-62343 dt. 03.12 . 2021

**Mbledhja Inauguruese
Kuvendi Komunal
03.12.2021**

PROCESVERBALI

I mbledhjes Inauguruese të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 03.12.2021

Mbledhjen e kryesoi anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal: Gani Krasniqi

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

- **10:00-10:15.** Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë;
- **Hapja me Himnin e Flamurit**
- **Një minutë Heshtje për Dëshmorët**
- **10:15- 10:30-** Fjala mirëseardhëse e Anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës;
- **10:30- 10:45-** Kryesuesi i mbledhjes Fton natarët e kuvendit
 - Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës;
 - Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës;
- **10:45-11:00-** Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës;
- **11:00-11:15 - Mbyllja e seancës.**

Prezent gjatë seancës inauguruese ishin: Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, të gjithë anëtarët të rinj të Kuvendit Komunal Drenas, familjar të dëshmorëve dhe martirëve, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, bashkësitë fetare, komandantja e Stacionit Policor, deputetë e anëtarë të PDK-së, këshilltari dhe vëllai i ish-presidentit të Kosovës, mysafirë dhe të ftuar përfaqësues të shoqërisë civile, qytetarë të Komunës së Drenasit

- **Hapja me Himnin e Flamurit**
- **Një minutë Heshtje për Dëshmorët**
- Fjala mirëseardhëse e Anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës;

Gani Krasniqi- përshëndeti të gjithë të pranishmit, dhe lexoj betimin për anëtarët e kuvendit.

-Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës;

Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal betohen njëzëri, ”betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Drenasit (Glllogoc) ,në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë” .

Në seancën inauguruese të Kuvendit të Komunës së Drenasit, në prani të anëtarëve të rinj të Kuvendit, familjar të dëshmorëve dhe martirëve, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, bashkësitë fetare, komandantja e Stacionit Policor, deputetë e anëtarë të PDK-së, këshilltari dhe vëllai i ish-presidentit, mysafirë dhe të ftuar, ka dhënë betimin kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci për mandatin e tretë në krye të komunës.

Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës;

Ramiz Lladrovci – betohet ”Betohem (ose deklaroj solemnisht) që do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat si kryetar i komunës së Glllogocit (Drenas) me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t’i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë” si kryetar i Komunës së Drenasit.

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës.

Pas dhënies së betimit, kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci të pranishmëve dhe gjithë qytetarëve të Komunës së Drenasit i është drejtuar me këtë fjalim:

Të dashur asamblistë,

Të nderuar,

Familjar të dëshmorëve dhe martirëve të UÇK-së,

Shoqata të dala nga lufta e UÇK-së,

Bashkësi fetare, z.Bequku dhe z.Sopi,

Komandante e Stacionit Policor, znj.Bajrami

I nderuar Blerim, vllau i presidentit Thaçi, dhe këshilltari z.Ismail Syla,

I nderuari z.Kuçi dhe z.Tahiri,

Zyrtarë komunal,

Zonja e zotërinj,

Qytetarë të Drenasit,

Pata nderin që sot para jush, të jap betimin për mandatin e tretë, në krye të komunës së Drenasit.

Ky betim për mua paraqet detyrim edhe obligim ligjor e moral që së bashku me juve, të bëjmë më të mirën e mundshme për qytetarët e komunës së Drenasit.

Sot, fillon një kapitull i ri, për mua dhe për Juve, sepse, shumica nga ju jeni për herë të parë në Asamblenë komunale, prandaj, nga ky moment, ua ofroj bashkëpunimin e plotë, të gjithëve pa dallim, pozitë e opozitë, pa dallim partie apo grupi kuvendor.

Ju uroj të gjithëve sukses e punë të mbarë, në përmbushjen e pritshmërisë së qytetarëve tanë.

Dua t'ju njoftoj se puna jonë në Asamblenë e kaluar ka qenë shembullore në nivel vendi, sepse, vërtetë jemi përpjekur dhe kemi punuar së bashku për interesin qytetar pa dallim se për kë kanë votuar apo çfarë bindjesh politike kanë pasur. Në veçanti dua ta theksoj bashkëpunimin në Asamble, gjatë kohës së pandemisë.

Uroj të kemi bashkëpunim, harmonizim dhe mirëkuptim, me qëllimin e vetëm, promovimin dhe realizimin e interesit qytetar, për të cilin jemi këtu dhe kemi marrë mbështetjen e tyre.

Ju uroj punë të mbarë, suksese të përbashkëta dhe përkushtim maksimal në zbatim të ligjit, realizimin e pritshmërisë së qytetarëve, me transparencë dhe llogaridhënie.

Na priftë e mbara, suksese!

Faleminderit!

Mbyllja e seancës- seanca perfundoj rreth ores 10:30

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Mbledhjes



Gani Krasniqi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/04-64439 dt. 16.12 . 2021

PROCESVERBALI

I mbledhjes se zgjedhjes të Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë:
16.12.2021

Mbledhjen e kryesoi anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal: Gani Krasniqi

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

- **10:00-10:15-** Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës
- **10:15- 11:30-** Kuvendi i Komunës zgjedh Kryesuesin e Kuvendit të Komunës
- **11:30- 11:45-** Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Komunës
- **11:45-12:00-**Mbyllja e seancës.



Prezent gjatë mbledhjes së rregullt ishin 31 anëtar të Kuvendit Komunal, Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci si dhe stafi i kryetarit.

Gani Krasniqi, E hapi mbledhjen e dytë të kësaj legjislature të Kuvendit të Komunës, fillimisht në bazë të nënshkrimeve në listën përkatëse konstatoj se **prezent ishin 31 anëtar**, andaj kuorumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me punë, dhe njoftoj me rendin e ditës:

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime **Gani Krasniqi** hodhi në votim rendin e ditës ku të pranishëm ishin 31 anëtar dhe të gjithë votuan në mënyrë unanime.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, sipas proceduarave ligjore, fillimisht duhet:

➤ **Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit.**

Gani Krasniqi -kërkoj nga anëtarët e Kuvendit Komunal që ta propozojnë komisionin.

Shefi i grupit Parlamentar të PDK-së **Bekim Lestrani** propozon që komisioni të formohet nga tre anëtar, dhe propozoj Qendrim Mulaj- për anëtar të komisionit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit Komunal.

Azemine Bujupi-Gjoka, nga Grupi Parlamentar DD propozon që komisioni të formohet nga 5 anëtar, ku propozoi për anëtar të komisionit Mehdi Salihu.

Nga Grupi Parlamentar VV **Egzona Tërdevci** propozon që komisioni të formohet nga 5 anëtar, ku propozoi për anëtar të komisionit Florentina Elezi-Veliu,

Nga Grupi Parlamentar GREEN propozon për anëtar të komisionit Beqir Kiqina.

Beqir Kiqina nga grupi parlamentar AAK propozon Filloreta Bujupin për anëtare të komisionit për zgjedhjen e kryesuesit.

Gani Krasniqi, fton anëtarët e Kuvendit Komunal që të votojnë komisionin me përbërje:

1. Qendrim Mulaj- PDK
2. Mehdi Salihu- DD
3. Florentina Elezi-Veliu- VV
4. Beqir Kiqina- AAK
5. Filloreta Bujupi- VV

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime Gani Krasniqi hodhi në votim Komisionin për zgjedhje të kryesuesit i cili u votua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi- ftoj grupet e parlamentare që të propozojnë kandidatin për kryesues të Kuvendit Komunal.

Bekim Lestrani nga grupi parlamentar i PDK-së propozon për kryesues të Kuvendit Komunal Milaim Hajdari.

Azemine Bujupi-Gjoka nga grupi parlamentar i DD-së propozon për kryesues të Kuvendit Komunal Salih Dvorani.

Gani Krasniqi sqaroi mënyrën e votimit, dhe pas 15 min pauzë filloi me procedurat e votimit, ku filloi rreth orës 10:45 dhe mbaroi rreth orës 11:05 min

Qendrim Mulaj- Kryetar i Komisionit pas procedurës së votimit për zgjedhjen e kryesuesit konstatoi se me rundin e parë u zgjodh për Kryesues të Kuvendit Komunal Milaim Hajdari me 19 vota kundërt Sali Dvoranit i cili kishte 12 vota.

Me 19 vota për, Milaim Hajdari nga Partia Demokratike e Kosovës, është zgjedhur kryesues i kuvendit komunal për mandatin 4 vjeçar në komunën e Drenasit.

Pas zgjedhjes së tij me shumicë votash, Milaim Hajdari ka falënderuar kryetarin Lladrovci për besimin e dhënë dhe përkrahjen e asamblistëve për të udhëhequr kuvendin komunal.


Në seancë morën pjesë 31 anëtarë, dhe komisioni për mbikëqyrjen e procesit të votimit u përkujdes që procesi i votimit të jetë konform legjislacionit në fuqi.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit


Milaim Hajdari